

Qyteti pa dashuri

“Nobel” për Natashën!

Duhet gjetur dhe lartësuar anët e mira njerëzore të "armikut" - përndryshe jemi të dënuar të na përsëritet historia... Në këtë kontekst, shpallja e Natasha Kandiçit "Qytetare nderi në Ferizaj" është punë e paqme, fisnike...

HALIL MATOSHI

Maksima nga tradita hebraike: "Më thuaj se jam i mirë, harroj se jam i keq, e ndiej veten mirë, punoj e veproj mirë dhe bëhem i mirë" si kurrë më parë vlen tani për marrëdhëniet shqiptaro-serbe, posaçërisht pas pavarësimit të Kosovës dhe agjendës proeuropiane të shumicës së qytetarëve kosovarë.

Për të nderuar djalin e tij të vranë nga një palestinez, Elias Khoury ka bërë përkthimin në arabisht të një prej romanëve më të njohur të Izraelit, "A Tale of Love and Peace", dhe është shkruar nga Amos Oz, një prej shkrimtarëve më të spikatur të vendit. Dhe synimi është t'i jepet një shans paqes duke e humanizuar tjetrin, duke treguar rrëfimet e historisë që i rrethon ata.

Në pyetjen e Christiane Amanpour (CCN) për Khouryn, se çfarë e kishte shtyrë ta përkthejë librin e Oz në arabisht, ai përgjigjet: "Siç e dini, e kam humbur djalin tim më 19 mars 2004, derisa ai po vraponte. Ai ka qenë student në Universitetin Hebraik dhe është qëlluar nga palestinezët, të cilët pretendonin se po bënin diçka heroike. Në atë kohë u njoha me një mik, një mik i përbashkët i imi dhe i Z. Oz, i cili erdhi të na vizitonte. Dhe po flisnim rreth asaj se si mund ta mbanim kujtesën e djalit tonë në një mënyrë që të ruhej për një kohë të gjatë".

Po çfarë do t'u thoshin kombeve të tyre ideatorët e Srebrenicës, Reçakut, Prekazit, Suharekës... po të mos kishte në atë shoqëri Natasha Kandiç? Çfarë do t'i kumtonin kombit serb vrasësit serikë që shiten si heronj të serbizimit, përse e vranë fëmijën Valmir Deliu në Obri me shishe qumështi në gojë, ose fëmijët e Berishëve në Suharekë, të Bogujevcëve në Podujevë – po të mos kishte ndërgjegje qytetare në Serbi si Natasha, e t'ua kumtonte serbëve të dehur nga propaganda fashiste se këta nuk ishin heronj, por horra të pështirë serbë.

pandëshkueshme. "Krime që as nuk mund të dënohen, e as të falen".

Asnjë lloj ndëshkimi nuk mund të jetë i drejtë kundrejt përmasave të Auschwitzit, Srebrenicës, Reçakut, Suharekës, por vlen vetëm si satisfaksion moral për viktimat.

Kandiç nuk është ndalur as gjatë regjimit fashist të Millosheviqit, duke e rrezikuar kokën, në hulumtimin e varrezat masive nëpër Serbi, që nga Batajnica, shkriktorja e "Trepçës" në Zveçan, shkriktorja "Maçkatica" afër Surdulicës etj., ku ishin katandisur (e ndoshta djegur) trupat e shqiptarëve të vranë gjatë luftës në Kosovë.

A nuk mundet shoqëria kosovare ta tejkalojë sindromën e "kulturës së krimit" – viktimitë e së cilës ishte vetë për dekada më radhë?

Dihet se e drejta ishte në anën e shqiptarëve dhe shi për këtë ShBA-ja dhe aleatët ndëshkuan Serbinë me bomba, ndërsa ideologun e barbarisë e çuan me biletë njëdrejtimëshe në Hagë, por e drejta është katëron që zhvendoset lehtë nga viktimat tek xhelati dhe anasjelltas.

Duke shikuar filmin-spektakël "Spartacus" të Goran Visnjicit, më bëri përshtypje skena kur Spartacus gozhdon komandosët e Crassit, ndërsa e shoqja shtatzënë Agripa e qorton: "Spartacus mos u bëj si ata"! Dhe Spartacusin e gjën i njëjti fat, ai gjatë një beteje zihet nga trupat e Crassit dhe gozhdohet, ndërsa Agripa zihet rob.

E di se viktimat mbajnë mend më së gjati. Por e di po ashtu se i vetmi shpëtim për viktimat dhe familjet e tyre është liria dhe shteti i Kosovës.

Kosova që pretendon të bëhet shtet e ka edhe këtë detyrim. Detyrim patriotik - ligjor.

Ende më 2010 jemi njerëz - jo numra, por tashmë me emër e mbiemër dhe në një territor të lirë, e jo nëpër kampe përqendrimi, megjithatë askush nga ne, njerëzit e Kosovës, nuk quhet Natasha Kandiç!?

Në shoqërinë serbe gjatë kohës së fashizmit konsensual të Millosheviqit ndodhi ajo që Hannah Arendt e ka cilësuar si të mësuarit (ambientimi) me të keqen dhe perceptimi masiv i së keqes si diçka e rëndomtë (ordinariteti), pra bashkëjetesa me krimin në jetën e përditshme. Por edhe sot e gjithë ditën racistët serbë thonë se Natasha po jep miliona për ta blerë çmimin Nobel (sic!) duke e quajtur "kudër kroate", e në anën tjetër, ka kosovarë që shohin në veprën e saj teori konspirative.

Por ne nuk guxojmë të lejojmë kurrë diçka të tillë brenda kombit tonë, kur gjatë, shumë gjatë kemi qenë vetë viktimë të gjuhës raciste dhe "trenave të vdekjes" e konc-llogoreve. Ne duhet të falim, për hir të idealit të shpresës. Kosovarët duhet ta ndërtojnë një shoqëri të hapur, të debatit, sepse të gjitha vlerat janë të debatueshme pos krimeve që kurrë nuk mund të marrin dënimin meritor, qofshin ato të nazi-fashizmit apo të komunizmit, qofshin ato të cionizmit apo islamit politik. Vetëm duke falur dhe duke parë e nxjerrë në pah anët e mira të armikut, kosovarët mund t'i përafrohen idealit veprues të demokracisë pa armiq (Giovani Sartori). Dua të besoj se pikërisht shoqëria e krizës do të prodhojë alternativa të reja, sidomos ndër të rinjtë mendje-hapur që nuk kapen pas tablove bardh-zi të origjinës dhe gjakut, pas pikëpamjeve historike dhe biologjike të botës. Ndiej një krenari, për më tepër një besim se po rilind një botë jo e errët konform me logjikën se përgjigjja më e mirë ndaj terroristëve dhe qeverive tona të këqija është të refuzojmë që të na frikësojnë.

Paketën e parë, në të cilën shkruante emri im dhe dëshmonte se ende jam gjallë, e jo vetëm numër për statistikë, e kam marrë nga Fondi për të Drejtën Humanitare të Natasha Kandiqit, pas shtatë muajsh në kampin e përqendrimit "Zabela" të Pozharevcit, diku në shtator 1999. Cigare, veshje sportive dhe gjësende për higjienë personale. Ishim ende njerëz – numra, kurse teshat e trupit pothuajse na ishin kalbur. Natasha na bëri të ndiheshim se ishim ende-njerëz! Filozofja e lirisë Hannah Arendt, edhe vetë viktimë e Holokaustit për krimet e luftës, thotë se ato janë të

Atë që nuk e kanë bërë institucionet e Kosovës e ka bërë ajo, Natasha.

Me qëllim të zbardhjes së vrasjes së Fehmi Aganit – shkruan Kandiq - sjell fakte që në mënyrë të pakontestueshme zbulojnë se si policët e përmendur, Nikolic Predrag dhe Dzeletovic Zoran, të njëjtën ditë kur është vrarë Agani, më 6 maj 1999, në hekurudhën Lypjan – Fushë-Kosovë, kanë varrë pesë anëtarë të familjes Blakqori: Miradijen (54), Fehmiun (60) dhe djalin e tyre Labinotin (14), Mahmutin (56) dhe të shoqen Sabilen (50). Kundër këtyre policëve, sikur edhe kundër Ivan Ivanovit, po ashtu pjesëtar i policisë në Fushë-Kosovë, SUP-i serb në Prishtinë, më 27 maj 1999, ka ngrehur padi penale (Ku.br.546/99). Dokumentacioni përcjellës, përfshirë edhe kërkesën e prokurorisë për të nisur hetimet, si dhe vendimi për hetimet dhe ndalimin e tyre, është sjellë në Serbi ose është shkatërruar. (...) Gjyqtarja Danica Marinkovic e paraqet veten si mbrojtëse të viktimave serbe dhe të policisë. Por ky manipulim i saj me opinionin publik është një betejë e humbur për të vërtetën. Brenda kësaj policie dihet e vërteta për vrasjen e Aganit. Dihet kush çfarë ka bërë në Kosovë, kush ka shtënë, kush i ka shmangur kufomat, kush me kamionë ka plaçkitur pronën e huaj..., shkruan Kandiq.

Çka mund të bëjë më shumë një grua serbe për shqiptarët?

Prandaj, Natasha Kandiq pos shpalljes "Qytetare..." e Ferizajt, pikërisht nga kosovarët duhet të nominohet për "Nobel" për paqe!

Dhe një ditë, një ditë kur të shikojmë përreth e të mos shohim më armiq (as realë dhe as të imagjinuar) do ta peshojmë më mirë veprën e saj dhe, një rrugë në këtë qytet pa dashuri, së paku të mbajë emrin e saj. Khoury dhe Oz që janë të vetëdijshëm se nuk do të zgjojnë dashuri të humbura dhe t'i nxisin kombet e tyre të përqafohen masivisht si në një karnaval. "Por do të përmirësojë aftësinë për të përfytyruar tjetrin, dhe unë mendoj se përfytyrimi i tjetrit është cilësi morale".

Kosovarët duhet ta bëjnë këtë kundrejt serbëve.